

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 50 paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë dhe nenet 16 dhe 17 të Rregullores për mbrojtjen e personave të mitur (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4898/1 datë 22.11.2024, pika 6 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4941 datë 27.11.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-5193/4 datë 26.12.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 46-të mbajtur më 25.12.2024 miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrje të masës - paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare për Veprimtarinë Radiodifuzive SPEKTRA, Komuna e Labunishtës SHPKNJP, për shkeljen e kryer të nenit 50 paragrafi (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV) dhe neneve 16 dhe 17 të Rregullores për mbrojtjen e personave të mitur (RRMPM), të mënyrës që në shërbimin programor televiziv të transmetuesit, më 4 nëntor 2024 filmat artistik "Vështirë për t'u vrarë Tezhok za ubivanje)" dhe "Kodrat kanë sy 2 (I ridovite imaat oči)" janë shënuar gabimisht si programe të kategorisë së dytë (8+) dhe janë transmetuar në periudhë kohore të papërshtatshme gjatë ditënatës - para orës 20:00, dhe filmi artistik "Të shpejtë dhe të tërbuar 7 (Brzi i besni 7)" në vend të programi të kategorisë së tretë (12+) është shënuar gabimisht si progra i kategorisë së dytë (8+).

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4941/1 datë 27.11.2024, i cili është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET Shoqëria Tregtare për Veprimtarinë Radiodifuzive SPEKTRA, Komuna Labunishtës SHPKNJP që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi ta harmonizon punën e saj me dispozitat e LSHMAAV dhe RRMPM.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave nga Ligji në fjalë, lejet, çertifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe aktet tjera të miratuara nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (radio transmetuesit) ndërmerr masë - vërejtje publike në pajtim me këtë ligj, në rastet kur ka cënim ose shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe aktet nënligjore miratuar në bazë të Ligjit, si dhe kushtet dhe detyrimet e përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 50 paragrafi (1) të LSHMAAV, transmetuesit nuk mund të transmetojnë ose shfaqin programe që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturve, veçanërisht programe që përmbajnë pornografi ose dhunë të tepruar. Ofruesit e shërbimeve, sipas kërkesës, duhet të marrin masat teknike më të rrepta për të siguruar që të miturit të mbrohen nga përmbajtja të dëmshme si dhuna e tepruar dhe pornografia. Përveç programeve nga paragrafi (1) i këtij neni, programe të tjera që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor dhe moral të të miturve, sigurohen nga ofruesit e shërbimeve mediatike

audiovizuale në mënyrë që të miturit të mos munden në mënyrën e zakonshme t'i shohin ose dëgjojnë programet. Kur programet transmetohen ose rishikohen në formë jo të koduar, ofruesi i shërbimeve mediatike audiovizuale është i detyruar që paraprakisht të siguron paralajmërim akustik dhe mundësinë që të njihet me ndihmën e shenjave vizuale gjatë gjithë transmetimit të programeve (neni 50 paragrafi 3 i LSHMAAV).

Neni 16 të RRMPM (periudha kohore për kategoritë e programeve) është përcaktuar në varësi të përbërjes së pritshme të publikut, kategoritë e programeve mund të transmetohen në periudhat e mëposhtme kohore: programet e kategorisë së parë dhe të dytë transmetohen gjatë gjithë ditës dhe natës; kategoria e tretë transmetohet në periudhën nga ora 20:00-05:00; kategoria e katërt transmetohet në periudhën nga ora 22:00-05:00; kategoria e pestë transmetohet në periudhën nga ora 00:00-05:00.

Neni 17 të RRMPM (përshkrimet e kategorive të programeve) ndër të tjera në pikat 2 dhe 3 parasheh se kategoritë e programeve audiovizive të përcaktuara në nenin 15 të kësaj Rregulloreje përcaktohen sipas përshkrimeve të mëposhtme: (2) Kategoria e dytë - programet që nuk rekomandohet për fëmijët nën 8 vjeç, për ndjekjen e të cilëve rekomandohet mbikëqyrja nga prindi ose kujdestari. Ato mund të transmetohen gjatë gjithë ditë-natës, me rekomandimin që të ndiqen nën mbikëqyrjen e prindit ose kujdestari. Është e mundur të trajtohen tema më serioze: sjellje devijante, dhunë në familje, racizëm dhe të ngajshme, por programet në asnjë rast nuk duhet të inkurajojnë ose përfshijnë ndonjë afirmim të sjelljes devijuese ose sjellje fyese për dinjitetin njerëzor. Nuk lejohet përdorimi i ekzagjeruar i fjalës së turpshme (vulgar). Lejohet pamje neutrale, natyrale e trupit të njeriut të zhveshur, por pa ndonjë kontekst seksual vulgar. Përshkrimet, skenat dhe/ose pamjet me erotikë duhet të jenë jashtëzakonisht të rralla dhe plotësisht të nënvlerësuara, të matura dhe pa aludime vulgare. Lejohet shfaqje e moderuar e dhunës, por pa detaje mizore, të justifikuar në komplotin e skenarit, pa theksuar praninë e armëve reale apo teknikave të rrezikshme për konfrontim ndërpersonal. (3) Kategoria e tretë - programe që nuk rekomandohen për fëmijët nën 12 vjeç, ndjekja e të cilave kërkon mbikëqyrjen e prindit ose kujdestarit. Programe, skenari i të cilave përfshin përshkrime sistematike dhe të shpeshta, skena dhe/ose pamje të dhunës psiko-fizike, që mund të shqetësojnë të miturit. Përpunimi (mbulimi) i temave serioze është i pranueshëm, por duhet të jetë i përshtatshëm për moshën e caktuar të publikut. Lejohet përdorimi i fjalës së turpshme, fyerjeve dhe brutalitetit, por duhet të reduktohet në masë të arsyeshme dhe të justifikohet me funksionin e nevojshëm në kontekstin dramatik ose informativ-dokumentar të programit. Përshkrimet, skenat dhe/ose pamjet e dhunës dhe erotikës, dhe ndërlidhja e mundshme midis këtyre dy faktorëve në zhvillimin e rrëfimit, nuk duhet të theksojnë dëmtimet fizike dhe/ose pasojat psiko-fizike të lëndimeve, as nuk duhet të përqendrohen në detaje fizike të turpshme. Nuk duhet të mbitheksohen armët dhe teknikat e konfrontimit ndërpersonal që janë të lehta për t'u imituar, me potencial të rrezikshëm për të ndikuar sugjestionues mbi personat psikologjikisht më pak të qëndrueshme dhe emocionalisht të cenueshme të publikut. Përshkrimi i varësisë nga droga lejohet, megjithatë, pa shtjellim të detajuar të fazave të aktit të karakterizimit të personazhit dhe plotësues në të gjithë llojet e ndryshme të programeve artistike, edukative, informative dhe/ose dokumentare. Njoftimet për programe të tilla nuk duhet të përbëhen nga përshkrime, skena dhe/ose pamje që mund të shqetësojnë të miturit.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Agjencia përmes Sektorit për Çështje Programore, më 27 nëntor 2024, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion SPEKTRA, Komuna e Labunishtës SHPKNJ. transmetuar më 4 nëntor 2024, në nivel lokal, ku është konstatuar shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenet 16 dhe 17 të RRMPM, të mënyrës që në kundërshtim në nenet 16 (periudha kohore për kategoritë e programeve) dhe 17 (përshkrimet në kategoritë programe) nga RRMPM, filmat artistikë "Vështirë për t'u vlarë Tezhok za ubivanje" dhe "Kodrat kanë sy 2(Ridovite imaat oči)" janë shënuar gabimisht si programe të Kategorisë së dytë (8+) dhe u transmetuan në interval kohor të papërshtatshëm. Sipas udhëzimeve të Rregullores për mbrojtjen e të miturve, për shkak të skenave të zgjatura të dhunës dhe torturës psikofizike, filmat artistikë duhet të klasifikohen në kategorinë e katërt (16+), program që nuk rekomandohet për fëmijët nën 16 vjeç, për të cilët është e nevojshme mbikëqyrja nga prindi/kujdestari dhe mund të transmetohet vetëm ndërmjet orës 22:00 dhe 05:00. Në kundërshtim me nenin 17 (përshkrimet e kategorive të programit) nga RRMPM, filmi artistik "Të shpejtë dhe të tërbuar (Brzi i besni) Fast & Furious 7 " janë shënuar gabimisht si program i Kategorisë së dytë (8+). Sipas udhëzimeve të RRMPM, filmi artistik duhet të klasifikohet si program i Kategorisë së Tretë (12+), që nuk rekomandohet për fëmijët nën 12 vjeç, për të cilët është i domosdoshëm mbikëqyrja nga prindi/kujdestari, dhe mund të transmetohet vetëm gjatë periudhës prej orës 20:00 deri në ora 05:00.

Shkelja nga pika 1 e këtij aktvendimi është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4941/1 datë 27.11.2024, që është pkesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në bazë të nenit 23 paragrafit (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion SPEKTRA, komuna Labunisht SHPKNJ, me datën 02.12.2024,dërgoi Shkresë nr.y në ark.10-49414/2 datë 02.12.2024, me të cilin ka dorëzuar Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-4941/1 datë 27.11.2024, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dërgon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV dhe RRMPM. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 05.12.2024, për të cilën Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive SPEKTRA, Komuna Labunishtë SHPKNJ, nuk ka dorëzuar deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV dhe RRMPM. Këshilli i

Agjencisë në seancën e mbajtur më 25.12.2024, ka shqyrtuar Raportin me shkrim dhe ka konstatuar t'i shqiptohet masë - vërejtje publike.

Srjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 50 paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë dhe nenet 16 dhe 17 të RRMPM, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për marrjen e masave (Teksti i pastruar), Raporti me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4941/1 datë 27.11.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-5193/4 datë 26.12.2024, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV dhe RRMPM, përcaktuara në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 46-të mbajtur më 25.12.2024, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron Shoqërinë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive SPEKTRA, Komuna Labunisht SHPKNJP, dhe urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV dhe RRMPM. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit..

Bazuar në sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4941/1 datë 27.11.2024

**Agjenci për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i aktvendimit.